



OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Elektriçist I Linjave TL** pranë OSSH / Drejtoria e Tensionit të Lartë / Dega Teknike / Sektori i Mirëmbajtjes TM.

ELEKTRIÇIST I Linjave TL

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për kryerjen e punëve të mirëmbajtjes sipas planit javor të punës, si dhe kryen mirëmbajtje të paplanifikuara kur është e nevojshme.
- Kryen punë të mirëmbajtjes parandaluese (monitorimin e rregullt të pajisjeve të shpërndarjes, matje të ngarkesës dhe tensionit) dhe riparime të ndryshme.
- Zbaton me përpikmëri Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm elektrik ose të jetë elektriçist i kualifikuar.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet.
- Aftësi shumë të mira komunikuese edhe punës në grup.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.